



Data	
Nr. Prot	

RELACION

VENDIMI

PËR

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË LEZHË, ME KANDIDATIN
NGA LISTA SHUMEMËRORE E “PARTISË UNITETI KOMBËTAR”, ZJ. GJULJANA
NDUE SEFERAJ**

**I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN
NË FUQI**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objekti që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionerit për ta shqyrtuar.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Me shkresën nr. 14867 prot., datë 10.09.2024, Këshilli i Bashkisë Lezhë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zj. Sidorela Gjon Kola, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Uniteti Kombëtar.

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumëmemërore e Partisë Uniteti Kombëtar, për këshillin e bashkisë Lezhë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 04 zj. Gjuljana Ndue Seferaj.

Me shkresën nr. 2687, prot., datë 13.09.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Lezhë zj. Gjuljana Ndue Seferaj, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet

pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumëmemërore, të subjektit Partia Uniteti Kombëtar, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër LE-PUK-602_1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Gjuljana Ndue Seferaj, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit me shkresën nr. 2777 prot., datë 23.09.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile, dhe me shkresën nr. 2780 prot., datë 23.09.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, për zj. Gjuljana Ndue Seferaj.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 10576/1 prot., datë 03.10.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Gjuljana Ndue Seferaj, ku konstatohet se kandidati ka ndryshuar mbiemrin me Akt Martese nga “FRROKU” në “SEFERAJ”.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 15143/1 prot., datë 02.10.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për zj. Gjuljana Ndue Seferaj, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Gjuljana Ndue Seferaj, në Këshillin e Bashkisë Lezhë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

Licela VELIU -Drejtorja e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit

Pavlina DOÇAJ -Drejtorja e Ligjshmërisë (në mungesë dhe me urdhër)

Majlinda ÇELMETA -Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)